

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN

“PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË PËRDORIMIT TË KULLOTAVE DHE LIVADHEVE PËR KULLOTJE OSE KOSITJE, PËR VEPRIMTARI SHOQËRORE, SHËNDETËSORE, SPORTIVE E TURISTIKE DHE PËR PRODHIMIN E ENERGJISË SË RINOVUESHME”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projektvendim ka për qëllim përcaktimin dhe formalizimin e tarifave për dhënien në përdorim të fondit kulloso dhe livadheve, për qëllime të kullotjes ose kositjes, si dhe për ushtrimin e veprimtarive me karakter shoqëror, shëndetësor, sportiv, turistik dhe për prodhimin e energjisë nga burime të rinvueshme.

Objektivat e këtij projektvendimi janë:

- Zbatimi i kuadrit ligjor në fuqi, ligji nr. 9693, datë 19.3.2007, “Për fondin kulloso”, i ndryshuar, si dhe akte të tjera përkatëse në fushën e mjedisit, pyjeve, energjisë dhe zhvillimit rural.**
- Nxitja e investimeve në energji të rinvueshme, në përputhje me objektivat kombëtare për energjinë e pastër (gjelbër), përmes përcaktimit të kritereve dhe tarifave për përdorimin e territorit për instalime të tilla.**
- Mbështetja e zhvillimit të veprimtarive ekonomike dhe komunitare, duke mundësuar përdorimin e livadheve dhe kullotave për qëllime bujqësore (kullotje, kositje), si dhe për veprimtari me interes publik (shëndetësore, edukative, sportive, turistike).**
- Krijimi i një sistemi të qartë dhe të unifikuar tarifor, që garanton transparencë dhe trajtim të barabartë për subjektet publike dhe private që kërkojnë përdorimin e këtyre sipërfaqeve.**
- Rritja e të ardhurave për njësitë e vetëqeverisjes vendore ose për strukturat përgjegjëse për administrimin e fondit kulloso, duke u mundësuar atyre të ri-investojnë në mirëmbajtjen, rigjenerimin dhe monitorimin e kullotave dhe livadheve.**

6. Rritja e eficiencës në administrimin e fondit kullosor, përmes vendosjes së detyrimeve financiare të lidhura me përdorimin sipas destinacionit dhe qëllimit të aktivitetit.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektvendimi që paraqesim për shqyrtim dhe miratim është planifikuar dhe është pjesë e Programit të Përgjithshëm Analistik të Projektakteve për vitin 2025.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ky projektvendim është në përputhje me politikat dhe strategjitet për nxitjen e investimeve dhe rritjen e të ardhurave për komunitetet vendore.

Me miratimin e tarifave, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe institucionet përgjegjëse për menaxhimin e fondit kullosor do të kenë një burim të rregullt të ardhurash.

Ky rregullim ligjor do të mundësojë një administrim më të mirë të territorit dhe do të reduktojë rastet e përdorimit pa leje ose të pakontrolluar të kullotave dhe livadheve.

Njëkohësisht, pritet që ky vendim të ndikojë pozitivisht në zhvillimin ekonomik të zonave malore dhe rurale përmes përdorimit të ligjshëm dhe të qëndrueshëm të burimeve natyrore.

Vendosja e tarifave të qarta, do të lehtësojë procedurat për subjekte të interesuara për veprimtari të ligjshme mbi territor, duke përshtypjet zhvillimet në fushën e agroturizmit, shëndetësisë, sportit dhe energjisë së pastër.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Relacion shpjegues për projektvendimin: “Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje e kositje, për veprimtari shoqërore, shëndetësore, sportive e turistike dhe për prodhimin e energjisë së rinovueshme”

Ky projektvendim është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe me kuadrin ligjor sektorial në fushën e pyjeve. Ai hartohet në zbatim të pikës 1 të nenit 15 dhe pikës 5 të nenit 17, të Kreut III të ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007, 'Për fondin kulloso', i ndryshuar.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projektvendimi nuk synon transpozimin e *acquis communautaire*.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi në përmbajtje të tij, parashikon përcaktimin e tarifave për përdorimin e kullotave dhe livadheve për kullotje e kositje, për veprimtari shoqërore, shëndetësore, sportive e turistike dhe për prodhimin e energjisë së rinovueshme, sipas shtojcave bashkëlidhur projektvendimit.

Konkretnisht në pikat 2, 3 dhe 4 janë përcaktuar tarifat për përdorim të kullotave e livadheve për kullotjen e bagëtive ose për kositjen e barit, të cilat janë sipas shtojcës (1); tarifat për dhënien në përdorim të kullotave e livadheve për veprimtari shoqërore, shëndetësore, sportive e turistike, të cilat janë sipas shtojcës (2) si dhe, tarifat për dhënien në përdorim të kullotave dhe livadheve për prodhimin e energjisë së rinovueshme, të cilat janë sipas shtojcës (3),

Pika 5, përcakton institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi, si Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencinë Kombëtare të Pyjeve dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Pika 6, parashikon shfuqizimin e Vendimit nr. 632, datë 11.6.2009, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje dhe kositje".

Sqarojmë se për përcaktimin e tarifave jemi bazuar në vlerat e tokës së kullotave dhe livadheve dhe i referohen rigorozisht të mirave/shërbimeve, dhe sidomos atyre që janë të matshme në treg ose që vlerësohen nga ky i fundit nëpërmjet çmimit te tregtimit te tyre. Vlerat e këtyre tarifave lidhen me vlerën e sasisë së barit që prodhojnë, kapacitetit mbajtës së tyre (numri i bagëtive që mund të kullosojnë në këto sipërfaqe), nisur nga vendndodhja gjeografike (zonë bregdetare, kodrinore e malore), nisur nga afërsia apo largësia nga qendrat e banuara, në varësi të funksionit, vlerës së bimëve

Relacion shpjegues për projektvendimin: "Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje e kositje, për veprimtari shoqërore, shëndetësore, sportive e turistike dhe për prodhimin e energjisë së rinovueshme"

mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore, faunës së egër dhe nivelit të investimeve apo infrastrukturës në to apo në afërsi të tyre.

Pra. jemi bazuar në vlerat direkt dhe indirekt të përdorshme, si dhe alternativat e tjera, gjithnjë duke patur parasysh reagimin e deri sotëm të interesit dhe vlerësimin e përgjithshëm mbi aktivitetet që zhvillohen aktualisht, kjo edhe në varësi të kohëzgjatjes së projekteve sipas miratimit nga institucionet e tjera sipas fushave të përgjegjësisë.

Tarifat sipas këtij projektvendimi mbështeten në VKM nr.89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, dhe tek vlera mjedisore, ekologjike dhe funksioni i sipërfaqeve të kullotave e livadheve. Gjithashtu mbështetet edhe tek VKM nr.559, datë 29.7.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të Fondit Pyjor Kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore”.

Konkretisht tarifat e kullotjes, lidhen me vlerën e sasisë së barit që prodhojnë, kapacitetit mbajtës së kullotave. Për kositjen tarifa ka një vlerë të ulët (2 lek) sepse bari kositet kryesisht në livadhe të cilat janë sipërfaqe jo të mëdha, shpenzimet për procesin janë të konsiderueshme (kositja, mbledhja dhe transporti), por ndihmojnë edhe në rigjenerimin e tyre.

Tarifat për ndërtimet agro-turistike janë përcaktuar referuar sipërfaqes që zënë strukturat turistike, duke i parashikuar të ulëta, me qëllim që të ndihmojnë dhe nxisin komunitetet që përfshihen në këto aktivitete, që të rrisin të ardhurat e tyre.

Tarifat për veprimtari sportive, çlodhëse dhe sportive janë sipas shtojës nr. 2, mund të jenë me kohë të shkurtër por edhe me zgjatje në kohë, por ndikimi në sipërfaqet e kullotave dhe livadheve janë minimale.

Përcaktimi i tarifave për dhënien në përdorim të kullotave dhe livadheve për prodhimin e energjisë së rinovueshme marrin parasysh kohëzgjatjen e projekteve në vite sipas llojit të aktivitetit, (ndikimit) efekteve në këto sipërfaqe dhe madhësisë së sipërfaqeve që nevojiten për projektet. Duhet theksuar se ndarja e kohëzgjatjes deri në 10 vite dhe mbi 10 vite, është sipas kohëzgjatjes së planeve të mbarështimit të kullotave që kanë afatin 10 vjeçar ligjor të zbatimit.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Relacion shpjegues për projektvendimin: “Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje e kositje, për veprimtari shoqërore, shëndetësore, sportive e turistike dhe për prodhimin e energjisë së rinovueshme”

Për zbatimin e këtij projektvendimi ngarkohet Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Pyjeve dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektvendimi është hartuar nga strukturat përgjegjëse për pyjet në bashkëpunim me Sektorin e Programimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, si dhe është konsultuar me të gjitha strukturat e vartësisë të ministrisë.

Ky projektakt i dërgohet për mendim Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Agjencisë për Mbështetjen e Njësive të Vetqeverisjes Vendore.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETOKE

Projektvendimi nuk ka efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit.

